



SHPLLJE PËR FURNIZIME DHE SHËRBIME

AKP e cila ka në Administrim të Drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore “Inex Sharr Planina ” Brezovicë , **SHPLLË** këtë:

FTESË PËR OFERTË

I. LËNDA E KONTRATËS

- a) **Shpallje publike për vendosjen e sistemit elektronik të biletave dhe vendosjen e sistemit të kamerave në kabinën për faturim dhe tek hyrja në teleferik**

Me qëllim të vendosjes së sistemit elektronik të biletave të NSH Inex Sharr Planina, AKP shpall tenderin publik për aktivitetet si në vijim:

1. Kontrollimi dhe përditësimi i softwerit të sistemit të faturimit elektronik;
2. Lidhja me sistemin e administratës tatimore ;
3. Blerja e 2000 biletave elektronike të cilat duhet të jenë të ndara:

- a) Bileta ditore;
- b) Bileta 7 ditore;
- c) Bileta 10 ditore;
- d) Bileta Mujore dhe
- e) Bileta sezonale

Biletat elektronike duhet të kenë bllokim kalimi pas 25 minutash nga momenti i aktivizimit në laurë.

Përpos këtyre aktivitetëve duhet të bëhet edhe vendosja e sistemit për vëzhgim të videove (kamerave) në kabinën për faturim dhe tek hyrja në teleferik.

Kërkesat teknike për operatorin ekonomik:

Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës ose të jetë konzorcium me kompaninë e regjistruar në Kosovë ose të ketë përfaqësuesin fiskal bazuar në legjislacionin në fuqi.

Duhet të ketë përvojë në furnizime dhe shërbime të ngjashme – Referencat.

Periudha për kryerjen e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve më së largu 15 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Operatori ekonomik fitues do të shpallet ai i cili i plotëson kriteret teknike dhe oferton me çmimin më të ulët.

Buxheti maksimal i lejuar për këtë aktivitet është 8,000.00 Euro.

AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për tu njohur më afër me aktivitetet që do të kryhen Operatorët ekonomik mund të bëjnë vizitë te

Qendra e Skijimit në Brezovicë çdo ditë punë nga data 21.10.2022 deri më 28.10.2022

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen më datën **28.10.2022** nga ora **13:00** deri në orën **14:00** në adresën e mëposhtme:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 Prishtinë.

Ofertat do të hapen me datën **28.10.2022** në ora **14:00** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Dritan Hoxha nr. 55, 10000 - Prishtinë .

- V. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.